



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

ADGJTHFR.nr.10/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, kryetari i gjykatës Mustaf Tahiri, duke vendosur në çështjen disiplinore, sipas ankesës për iniciimin e procedurës disiplinore të parashtruar nga pala ankuese Rr.B.G.H. – BIRN, me seli në Prishtinë, “M.S.”, Kati i ..-rë, Rr. “A.Zh.” Nr. ..., me pretendimin për shkelje disiplinore nga gjyqtari i Gjykatës Themelore në Ferizaj Sh.I., në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 3 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, më 18.09.2023 mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Sh.I., e paraqitur nga pala ankuese Rr.B.G.H. – BIRN, me seli në Prishtinë, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj përkatësisht autoriteti kompetent i kësaj gjykate - kryetari i gjykatës Mustaf Tahiri, *(në tekstin e mëtejshëm autoriteti kompetent)*, më 31 gusht 2023, përmes e_mail-it elektronik ka pranuar ankesën e ushtruar nga ankuesi Rr.B.G.H. – BIRN, kundër gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj Sh.I.

Ankuesi Rrjeti Ballkani i Gazetarisë Hulumtuese – BIRN, në ankesën e ushtruar ka theksuar se: gjyqtari i çështjes Sh.I., në trajtimin e rastit lidhur me veprat penale *“shmangia nga tatimi”* nga neni 313 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së; *“dokumentet e rrejshme lidhur me tatimin”* nga neni 314 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së; *“ndihmë në kryerjen e veprës penale dokumentet e rrejshme lidhur me tatim”* nga neni 314 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe neni 33 të KPRK-së, ndaj të pandehurve E.H, V.H-F, D.V, N.B (lënda është veçuar) H.E dhe Sh.I, duke konsideruar se ka marrë veprime të pa renditura sipas Kodit të Procedurës Penale. Ankuesi, po ashtu ka theksuar se konsideron se gjyqtari i çështjes nuk ka kryer ashtu siç duhet detyrat e tij siç janë të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale, në gjykimin e kësaj çështje, ashtu që në seancën e datës 26 korrik 2023, gjyqtari me të filluar seancën nuk ka konstatuar palët prezentë në sallë të gjykatës, mos konstatim nga i cili ka rezultuar se gjatë dhënies së dëshmisë së dëshmitari M. M në datën e lartcekur, dëshmitari H.E dhe N.H kanë qenë prezent gjatë dhënies së dëshmisë së dëshmitarit M.M, të cilat veprime janë në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe atë me neni 326 *“marrja në pyetje e dëshmitarit apo ekspertit pa praninë e dëshmitarëve të tjerë”* ku specifikisht thuhet se dëshmitari i cili nuk është marrë në pyetje nuk mund të jetë i pranishëm në seancë derisa një dëshmitar jep dëshminë e tij lidhur me rastin, mbi bazën e të cilave ankuesi ka theksuar se gjyqtari ka bërë shkelje, duke kërkuar që të iniciohet procedura disiplinore ndaj gjyqtarit, pasi që konsiderojnë se me veprimet e të njëjtit dëmtohet reputacioni i Gjykatës ose mund të aludohet në paanshmëri të Gjykatës dhe se veprimet e tilla përpos që dekurajojnë qytetarët ti ndjekin procedurat gjyqësore, ndikojnë negativisht edhe në besimin ndaj sistemit të drejtësisë përgjithsisht nga ana e shoqërisë, e veçmas në organet e ndjekjes duke ja bashkangjitur kërkesës si provë fotografitë gjatë seancës gjyqësore. Për më tepër shih¹.

Gjyqtari i ngarkuar me këtë çështje Sh.I., në deklaratën e tij me shkrim lidhur me pretendimet e palës ankuese, ka theksuar se: lidhur me pretendimeve të ankuesit, me përgjegjësi të plotë deklaroi se nuk qëndrojnë, për shkak se edhe nga përmbajtja e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datë 26.07.2023, ngase ankuesi pretendon se nuk kam konstatuar prezencën e palëve në shqyrtim, kurse e vërteta është se kam konstatuar prezencën e palëve dhe atë të palëve

¹ Kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore, dt. 31.08.2023

të cilat i kam ftuar pra qëndron emri i dëshmitarit të ftuar M.M, ndërsa nuk kam konstatuar prezencën e dëshmitarëve tjerë që nuk kanë qenë të ftuar, por siç shihet kanë qenë prezent që për shkak të numrit të madh të pjesëmarrësve (pesë të akuzuar dhe mbrojtësit e tyre) në seancë, ngase seanca ishte publike, vendet ku ishin ulur dhe afërsisë familjare me të akuzuarit kanë ardhur në seancë edhe pa qenë të ftuar por se unë nuk i kam njohur dhe kjo ka qenë arsyeja pse nuk i kam larguar gjatë dëgjimit të dëshmitarit dhe në seancën e radhës së datës 31.07.2023, pas konstatimit së dëshmitarët H.E dhe N.H kanë qenë në sallë me datë 26.07.2023 kam marr aktvendim që të njëjtit mos të dëgjohen në cilësi të dëshmitarëve mu për shkak të prezencës së tyre gjatë dëgjimit të dëshmitarit M.M. Ndërsa sa i përket pretendimit të ankuesit se me veprimin tim dëmtohet reputacioni i gjykatës ose mund të aludohet në paanshmërinë time, konsideroj se nuk qëndron ngase reputacioni i gjykatës dëmtohet me mosveprime dhe vendime që dalin nga këto raste dhe jo me veprime procedurale që vet palët mund ti atakojnë në procedurën e ankimimit. Për më tepër shih².

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, si autoritet kompetent për pranimin e ankesave ndaj gjyqtarëve dhe vendosjen e tyre, pasi shqyrtoi ankesën-kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore me pretendimet e cekura në ankesën e ankuesit e të përshkruara si më lartë, shkresat tjera në dispozicion, gjeti se ankesa për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit Sh.I. është e pa bazuar.

Nga faktet e çështjes rezulton se Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm Penal, me aktakuzën PP/II.nr.859-1/18 të datës 04.05.2020, ka ngritur aktakuzën ndaj të pandehurve E.H për shkak të veprës penale shmangia nga tatimi nga neni 313 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, ndaj të pandehurës V.H-F për shkak të veprës penale shmangia nga tatimi nga neni 313 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, ndaj të pandehurit D.V për shkak të veprës penale dokumentet e rrejshme lidhur me tatimin nga neni 314 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, ndaj të pandehurit N.B., për shkak të veprës penale dokumentet e rrejshme lidhur me tatimin nga neni 314 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, ndaj të pandehurit H.E për shkak të veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale dokumentet e rrejshme lidhur me tatimin nga neni

² Deklarata e gjyqtarit dt. 05.09.2023, Procesverbalet e dt.26.07.2023, 31.07.2023.

314 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 33 të KPRK-së si dhe ndaj të pandehurit Sh.I., për shkak të veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale dokumentet e rrejshme lidhur me tatimin nga neni 314 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 33 të KPRK-së.

Sipas procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 26.07.2023, gjyqtari i çështjes Sh.I., ka konstatuar pjesëmarrjen e të pranishmëve në këtë shqyrtim, dhe atë prezencën e Prokurorit të shtetit, të pandehurit E.H dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit av.Q.Z., të pandehurës V.H-F dhe mbrojtësit të saj av.B.P., të pandehurit D.V dhe mbrojtësit të tij av.N.Q., të pandehurit H.I dhe mbrojtësit të tij av.A.D., të pandehurit Sh.I, dëshmitarit M.M si dhe përkthyesi gjuhësor M.Z, në të cilën seancë gjyqësore në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar M.M.

Kryetari i Gjykatës vlerëson se pretendimet për shkelje disiplinore të palës ankuese se gjyqtari Sh.I., nuk ka kryer ashtu siç duhet detyrat e tij siç janë të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale në gjykimin e kësaj çështje ngase në seancën e datës 26.07.2023 nuk ka konstatuar palët prezentë dhe se gjatë dhënies së dëshmisë së dëshmitarit M.M., kanë qenë prezent dëshmitarët H.I. dhe N.H., duke i konsideruar si veprime në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale nenit 326 *“marrja në pyetje e dëshmitarit apo ekspertit pa praninë e dëshmitarëve tjerë”*, janë të pabazuara, ngase trajtimi dhe vlerësimi i shkeljeve të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale (siç edhe janë ngritur pretendimet ankimore nga ankuesi), është jashtë sferës së autoritetit kompetent për ti trajtuar dhe vlerësuar, dhe se shkeljet e tilla nuk mund të konsiderohen si shkelje disiplinore, megjithatë të njëjtat pretendime për çfarëdo shkelje të këtyre dispozitave, mund të jenë shkak apo arsye për ushtrimin e mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike në gjykatat me të larta nga cilado palë e pakënaqur në procedurë.

Andaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Ferizaj lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerëson se nuk ka bazë të

arsyeshme se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga arsyet e shpjeguara më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

ADGJTHFR.10/23

Datë 18 shtator 2023

Mustaf TAHIRI

Kryetar i Gjykatës

Iu dërgohet:

- Rr.B.G.H. – BIRN, me seli në Prishtinë, “M.S.”, kati ...-rë, Rr. “A.Zh.” Nr. ..., - Parashtrues i ankesës,
- Sh.I. - Gjyqtar,
- Këshillit Gjyqësor të Kosovës.